

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 1568/3, datë 14.7.2015

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE PORTUALE NË
AUTORITETIN PORTUAL DURRËS PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 84 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të këshillit drejtues të Autoritetit Portual Durrës, miratuar me vendimin nr. 5, datë 2.3.2015, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për shërbimet portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2015, caktohen sipas lidhjes që i bashkëngjitet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Niveli i tarifës është shprehur pa TVSH.

2. Institucioni përgjegjës për vjeljen e tarifave është Autoriteti Portual Durrës, ose subjekte të autorizuar prej tij.

3. Udhëzimi nr. 581/1, datë 6.2.2013 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani